



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 6080 Prot.

Lezhë, më 06 . 04 . 2021

VENDIM

Nr. 70 Datë 30 . 03 . 2021

PËR

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmes financiare për dëmin e shkaktuar nga permytja të banesës së shtetasit Kreshnik Ruzhdi Rustja, banor në Shengjin, Njësia Administrative Shengjin, Bashkia Lezhë.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" Ligji Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM Nr.329, dt.16.05.2012 "Për Kriteret dhe Procedurat e dhenies së ndihmes shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njëzore", pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile, mbi dëmin e shkaktuar në banesën e Z.Kreshnik Ruzhdi Rustja, banor në Shengjin, Njësia Administrative Shengjin, Bashkia Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbështetje financiare të shtetasit Z.Kreshnik Ruzhdi Rustja për dëmtimin e banesës së tij nga permytja.

A. Të miratojë dëmin e shkaktuar nga permytja në vlerën 76500 lekë.

a) Demi i shkaktuar në ndertese 0 lekë.

b) Demi i shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje 76500 lekë.

B. Mbështetur në VKM. Nr 329 dt.16.05.2012, kap3, pika 3, germa b e ç, Kompensimi për dëmin e shkaktuar në anën ndertimore të jetë në masën 50%, ndërsa Kompensimi për dëmin e shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje, mbështetur në kap 3, pika 3, germa d, të VKM-së së mesipërme të jetë sa masa e dëmit të shkaktuar dhe konkretisht :


a) Vlera e Kompensimit të dëmit në anën ndertimore të jetë 0 lekë.

b) Vlera e Kompensimit të dëmit në orendi, mobilje e pajisje 76500 lekë.

Vlera totale 76500 lekë.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.
3. Bashkia Lezhe t'i akordoje familjes së shtetasit Z.Kreshnik Ruzhdi Rustja me Nr.ID. H00525058Q ndihmen emergjente në vleren prej 76500 (shtatedhete e gjashte mije e peseqind) lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkise per vitin 2021, bazuar ne VKM nr.329 dt.16.05.2012.
4. Ndhma financiare që do t'i akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihme familjes së shtetasit Z.Kreshnik Ruzhdi Rustja, banesa e të cilit është dëmtuar nga permbytja.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**

